

DEKRET
Nr. 99, datë 17.3.2025

**PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI
MENJËHERË TË LIGJIT**

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 18/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent i huamarrësit dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian, si huadhënës, për ‘Lehtësinë e reformës dhe zgjerimit për Ballkanit Perëndimor’”.

Neni 2

Dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 18/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent i huamarrësit, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian, si huadhënës, për ‘Lehtësinë e reformës dhe zgjerimit për Ballkanin Perëndimor’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj